



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE

LICENCË PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME ENERGJI ELEKTRIKE

DHËNË :

KORPORATËS ENERGETIKE TË KOSOVËS SH.A

Divizioni i Furnizimit

Numri i Regjistrimit: ZRRE/Li_07/12



PËRMBAJTJA

KREU I: TERMAT E LICENCËS.....	3
KREU II: KUSHTET E LICENCËS	4
Neni 1: Përkufizimet.....	4
Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Furnizuesit Publik.....	5
Neni 3: Tarifat dhe Ndalimi i Subvencionimeve dhe ndërsuvencionimeve.....	6
Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji	6
Neni 5: Detyrimet e të Licencuarit	6
Neni 6: Blerja Ekonomike e Energjisë Elektrike, Aseteve dhe Shërbimeve	7
Neni 7: Mbrojtja e Konsumatorëve.....	7
Neni 8: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes	8
Neni 9: Rregullat e Tregut	8
Neni 10: Shëndeti dhe Siguria	8
Neni 11: Puna	8
Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit	9
Neni 13: Obligimi i Shërbimit Publik	9
Neni 14: Furnizuesi i Burimit të Fundit	9
Neni 15: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së	10
Neni 16: Vazhdimi,Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës.....	11
Neni 17: Taksat.....	11
Neni 18: Masat Administrative dhe Gjobat	11
Neni 19: Zgjidhja e Kontesteve.....	11



KREU I: TERMAT E LICENCËS

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji** (tani e tutje "ZRRE"), në pajtim me autoritetit e dhënë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Nenin 15 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L – 201) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, **i modifikon Korporatës Energjetike të Kosovës ("KEK") SH.A-Divizionit për Furnizim** (tani e tutje "i Licencuari") **licencën për furnizim publik me energji elektrike.**
2. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari ka të drejtë të:
 - 3.1. shes, në baza ekskluzive energji elektrike konsumatorëve tarifor (të rregulluar) me tarifë të rregulluar, në përputhje me këtë licencë;
 - 3.2. blejë energji elektrike nga gjeneruesit e energjisë elektrike me tarifa të rregulluara në përputhje me Nenin 7 të Ligjit për Energji Elektrike dhe Nenin 41 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 3.3. blejë kapacitetet dhe energji elektrike nga gjeneruesit apo furnizuesit e tjerë me tarifa të parregulluara, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - 3.4. shesë kapacitete dhe energji elektrike për ndërmarrjet tjera të energjisë elektrike të licencuara, në pajtim me procedurat e specifikuar nga ZRRE, në rast se kërkesat e konsumatorëve të tij për energji elektrike zvogëlohen nën nivelin për të cilin është kontraktuar;
 - 3.5. importojë kapacitete dhe energji elektrike në përputhje me Nenin 18 paragrafi 2 të Ligjit për Energji Elektrike;
 - 3.6. eksportojë kapacitete dhe energji elektrike në rast kur kërkesat e konsumatorëve për energji elektrike janë më të vogla se kapaciteti i kontraktuar;
 - 3.7. faturojë dhe inkasojë të hyra nga konsumatorët e vet në pajtim me Nenin 18 paragrafi 8 të Ligjit për Energji Elektrike dhe Rregullat në fuqi;
 - 3.8. merret me ankesat e konsumatorëve të vet;
 - 3.9. furnizojë me energji elektrike konsumatorët e kualifikuar me tarifa të parregulluara kur kjo kërkohet nga konsumatorët e kualifikuar, në përputhje me kërkesat e kësaj licence, Ligjin për Energji Elektrike dhe legjislacionin në fuqi.
4. Licenca vlen nga data **4 Tetor 2006** dhe do të vazhdojë të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri me **4 Tetor 2036**, me mundësi vazhdimi në përputhje me Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
5. Në pajtim me Nenin 34 paragrafin 1 nënparagrafin 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë modifikon licencën për furnizim publik me energji elektrike me numër ZRRE/Li_07/06 e lëshuar me datë 04 tetor 2006 nga Zyra e Rregullatorit për Energji, dhe hynë në fuqi me datë **18.07.2012.**

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me datë:_____.

Nënshkruar (në emër të Bordit të ZRRE-së):_____.



KREU II: KUSHTET E LICENCËS

Neni 1: Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:

"Anëtar" - marrëdhënia e drejtpërdrejt ose indirekte me të Licencuarin, çdo ndërmarrje Aksionare apo Vartës i të Licencuarit, apo ndonjë vartës të një ndërmarrje Aksionare të të Licencuarit, e themeluar sipas legjislacionit në fuqi.

"Vit financiar" - është periudha prej 1 Janar deri me 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.

"Legjislacion" – Ligji për Energjinë (Ligji Nr. 03/L - 184), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L - 185), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 03/L - 201) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.

"Rregulla të Tregut" - rregulla të miratuara nga ZRRE që përcaktojnë funksionimin e tregut të energjisë elektrike dhe raportet në mes të Operatorit të Tregut dhe pjesëmarrësve në treg, si dhe bashkëveprimet midis këtyre palëve dhe Operatorit të Sistemit të Transmisionit.

"Kode" - rregullat teknike të përpiluara nga Operatori i Sistemit të Transmisionit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes sipas Ligjit për Energjinë Elektrike dhe të aprovuara nga ZRRE-ja, në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.

"Marrëveshje për Blerje të Energjisë" – marrëveshja për blerjen e energjisë elektrike me prodhuesin e energjisë në pajtim në Nenin 18 të Ligjit për Energjinë Elektrike.

"Vartës" - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, e që definohet sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.

"Konsumator i kualifikuar" - konsumatori që është i lirë të blejë energji elektrike nga furnizuesi të cilin ai/ajo e zgjedh.

2. Termet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptim si termet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.



Neni 2: Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Furnizuesit Publik

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare vjetore në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga ZRRE-ja dhe do t'i dorëzojë një kopje të Pasqyrave Financiare të audituar brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Llogaritë e brendshme duhet të jenë të ndara për aktivitetet e Furnizuesit Publik nga llogaritë e brendshme për aktivitetet e tjera, sikur këto aktivitete të kryheshin nga ndonjë ndërmarrje tjetër.
2. I Licencuari do të dorëzojë në ZRRE Pasqyrat Financiare vjetore të audituara nga auditori i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar.
3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Furnizuesit Publik në tërësi dhe po ashtu llogari të ndara për:
 - 3.1. Furnizim të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të parregulluara,
 - 3.2. furnizim të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të rregulluara, dhe
 - 3.3. furnizim të konsumatorëve të jo-kualifikuar.
4. Llogaritë e ndara sipas paragrafit 3 të këtij Neni, do të përgatiten në pajtim me Nenin 46 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë. Nëse kërkohet nga ZRRE-ja kohë pas kohe, i Licencuari duhet të dërgoi të gjitha llogaritë në formë dhe datën e specifikuar nga ZRRE. Kontabiliteti rregullativ do të mbahet në përputhje me Udhëzimet e ZRRE-së lidhur me raportimin e pasqyrave Rregullative, dhe ndër të tjerash mund të specifikojnë:
 - 4.1. formën e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm nga llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilancet, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, asetëve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë aktivitet tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve të konsoliduara të Furnizimit Publik dhe aktiviteteve të tjera;
 - 4.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave rregullativ të kontabilitetit, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, asetëve ose borxheve, si dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara;
 - 4.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
5. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk duhet, sa i përket gjendjeve llogaritë në lidhje me vitet financiare, të ndryshoj bazat e pagesave, ndarjen ose alokimin nga ato të aplikuara në vitet e mëhershme financiare,



përveç nëse ZRRE-ja ka lëshuar më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.

6. Licencuari do të veprojë në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga ZRRE-ja, dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 3: Tarifat dhe Ndalimi i Subvencionimeve dhe ndërsuvencionimeve

1. Të gjitha tarifrat që do të ngarkohen nga i Licencuari për kryerjen e aktiviteteve të dhëna me licencë, duhet të vendosen në përputhje me Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike të aprovuara nga ZRRE.
2. I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti i furnizimit publik të japë apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtarit dhe/ose ndonjë personi tjetër.
3. I Licencuari gjithashtu do të sigurojë se nuk do të lejojë ndonjë ndër-subvencion (direkt ose tërthortë) në mes të konsumatorëve të kualifikuar me tarifa të rregulluara dhe të parregulluara, dhe as në mes të konsumatorëve të kualifikuar dhe jo-kualifikuar të tij, dhe as në mes të ndonjë konsumatori tjetër të tij individual apo kategori konsumatorësh, përveç në nivelin e aprovuar nga ZRRE.

Neni 4: Pajtueshmëria me Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Rrjetit, Kodet e Matjes dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji

1. I Licencuari do të veprojë në përputhje me dispozitat e Kodit të Shpërndarjes, Kodit të Rrjetit , Kodeve të Matjes dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e atyre dispozitave që nuk është e mundur të zbatohen sipas paragrafit 1 të këtij Neni. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 5: Detyrimet e të Licencuarit

1. I Licencuari do të kryej aktivitetin e licencuar në Kosovë në mënyrë efektive, ekonomike dhe të koordinuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari do të ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme që të zbatoj obligimet sipas legjislacionit në fuqi dispozitat e kësaj licence dhe marrëveshjet e lidhura me palë duke përfshirë çdo Marrëveshje për Blerjen e Energjisë (MBA).



3. I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Nenit 18 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe t'i ndërmarr të gjitha masat e nevojshme që të veproj në përputhje me ato kërkesa me qëllim që të garantojë pavarësinë e tij.

Neni 6: Blerja Ekonomike e Energjisë Elektrike, Aseteve dhe Shërbimeve

1. Në kontratat ose marrëveshjet për blerje të energjisë elektrike, asetëve, ose shërbimeve që janë të nevojshme për kryerjen e detyrimeve të të Licencuarit sipas kësaj licence dhe legjislacionit në fuqi, i Licencuari do të blejë atë energji elektrike, asete ose shërbime nga burimet më ekonomike të disponueshme për të.
2. Duke marrë parasysh burimet më ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë dhe sigurinë e burimeve të energjisë elektrike, asetet dhe shërbimet në kohën e blerjes, dhe sipas nevojave të tij, në mënyrë që t'i mundësojë atij që të kryejë detyrimet e tij sipas legjislacionit në fuqi dhe kësaj licence. I Licencuari do të mbajë evidencë adekuate për të gjitha këto kontrata ose marrëveshje, dhe kur ZRRE-ja kërkon, i Licencuari do të dëshmojë se ka zbatuar këtë detyrim për blerjen ekonomike, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Neni 7. Mbrojtja e Konsumatorëve

1. I Licencuari do të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues ndaj të gjithë konsumatorëve, me respekt ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tyre në lidhje me shërbimet e energjisë elektrike.
2. I Licencuari është përgjegjës për mbrojtjen e konsumatorëve të vet, duke bërë adresimin e ankesave në lidhje me çdo veprim, mospërfillje ose shkelje të bëra nga vet furnizuesi apo operatori i sistemit, si dhe duke bërë përpjekje të arsyeshme për të zgjidhur këto ankesa.
3. I Licencuari duhet të sigurojë të paktën një zyrtar gjatë orëve të punës, që t'iu përgjigjet pyetjeve dhe kërkesave të konsumatorëve.
4. Zyrtarët e të Licencuarit, që janë përgjegjës për pranimin e thirrjeve telefonike dhe pranimin e konsumatorëve në zyrë, duhet të jenë të kualifikuar dhe të udhëzuar siç duhet, për mënyrën e trajtimit korrekt dhe me shpejtësi çështjet e ankesave/kontesteve dhe kërkesave për shërbim apo t'i udhëzojë në departamentin përkatës.
5. I Licencuari është i detyruar t'iu përgjigjet të gjitha ankesave të konsumatorëve, në mënyrë efikase dhe të drejtë, në pajtim me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
6. I Licencuari do të informoj konsumatorët e tij për adresën postale, numrin e telefonit, numrin e faksit dhe adresën elektronike të shërbimit të informatave, që i ka themeluar me qëllim të pranimin të ankesave të tyre apo raportimit të ndonjë incidenti.



Neni 8: Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përmbushjes

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të aprovuara nga ZRRE.
2. Kur ZRRE kërkon, apo kur i Licencuari e konsideron të arsyeshme, i Licencuari do të shqyrtojë standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përmbushjes brenda afatit të përcaktuar nga ZRRE.
3. I Licencuari do të zbatojë standardet e aprovuara dhe do t'i propozojë ZRRE-së për aprovim procedurën e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë të furnizimit dhe shërbimit. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
4. I Licencuari do t'i sigurojë ZRRE-së jo më vonë se 31 Mars të çdo viti kalendarik raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij Neni.
5. I Licencuari me 31 Mars të çdo viti kalendarik do të publikojë statistikën ashtu si ZRRE-ja i kërkon, lidhur me përmbushjen ose mos-përmbushjen e standardeve të performancës, të përcaktuara sipas këtij Neni.

Neni 9: Rregullat e Tregut

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me Rregullat e Tregut në fuqi.
2. I Licencuari mund të kërkojë derogim (shtyrje) në zbatimin e disa dispozitave të Rregullave të Tregut. ZRRE-ja pas shqyrtimit të kërkesës nga i licencuari mund të lejojë apo refuzojë derogimin (shtyrjen) e afatit të zbatimit.

Neni 10: Shëndeti dhe Siguria

1. I Licencuari do t'i ndërmerr të gjithë veprimet e nevojshme për të mbrojtur personat nga lëndimet që mund t'u shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Furnizimit Publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditim) teknik dhe të sigurisë së tij në baza vjetore, dhe rezultatet e një kontrolli të tillë do t'i dërgojë në ZRRE, sa herë që kjo kërkohet nga ZRRE-ja.

Neni 11: Puna

I Licencuari lidhur me marrëdhënien në punë dhe sigurinë në punë do të veprojë në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.



Neni 12: Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit

1. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa ZRRE-ja nuk e aprovon.
2. I Licencuari do të njoftojë ZRRE-në për ndonjë ndryshim të Strukturës Organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet ZRRE-së jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.

Neni 13: Obligimi i Shërbimit Publik

I licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimit publik që mund t'i vendoset nga ZRRE-ja sipas Nenit 47 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.

Neni 14: Furnizuesi i Burimit të Fundit

1. ZRRE-ja me njoftim me shkrim (udhëzim) mund të obligojë të Licencuarin që të furnizojë me energji elektrike cilindo konsumator.
2. Paragrafi 1 i këtij Neni do të aplikohet kur ZRRE-ja:
 - 2.1. i ka tërhequr licencën për furnizim ndonjë Furnizuesi tjetër të energjisë elektrike, nga i cili konsumatori është furnizuar; dhe
 - 2.2. vlerëson se i Licencuari mund të përmbushë obligimet e furnizuesit të fundit sipas paragrafit 1 të këtij Neni, pa paragjykuar aftësitë e tij për:
 - 2.2.1. vazhdimin e furnizimit të konsumatorëve; dhe
 - 2.2.2. përmbushjen obligimeve kontraktuale për furnizim me energji elektrike.
3. Udhëzimi për furnizim nga burimi i fundit do të hyjë në fuqi prej datës së revokimit/tërheqjes të licencës së furnizimit të Furnizuesit tjetër dhe do të vazhdojë për një periudhë të specifikuar në udhëzim.
4. I licencuari do të furnizojë me energji elektrike konsumatorët që më parë furnizoheshin nga Furnizuesi tjetër në ato objekte siç i janë specifikuar ose përshkruar në udhëzimin për furnizim nga burimi i fundit.
5. Menjëherë pasi që ZRRE-ja të ketë nxjerrë udhëzimin për furnizim nga burimi i fundit, i Licencuari sipas udhëzimit të ZRRE-së do të nxjerrë një njoftim dhe do të dërgojë nga një kopje të njoftimit te secili konsumator. Njoftimi që do të dërgohet do të:
 - 5.1. informojë konsumatorin në fjalë se ai nuk do të furnizohet më tutje nga Furnizuesi tjetër;



- 5.2. informojë konsumatorin në fjalë se i Licencuari është bërë Furnizues i energjisë elektrike për konsumatorin nga data e hyrjes në fuqi të udhëzimit; dhe
 - 5.3. vendos detyrime, që duhet të paguhen për furnizim me energji sipas udhëzimit ose me një shpjegim se si janë përcaktuar detyrimet.
6. I Licencuari do të ngarkojë konsumatorin e burimit të fundit me tarifa që i ngarkohen konsumatorëve të tjerë të cilët furnizohen në të njëjtën kategori të konsumatorëve si konsumatori në fjalë. Kostot potenciale shtesë që asocohen me shërbimin e konsumatorit në fjalë do të alokohen te konsumatorët e tjerë të të Licencuarit, në mënyrë transparente dhe jo-diskriminuese.
 7. Në rastet kur kategoria të cilës i përket konsumatori që kërkon shërbimin e burimit të fundit furnizohet me çmime të rregulluara, i Licencuari obligohet që ZRRE-në ta njoftojë me shkrim lidhur me kostot eventuale shtesë që ndërlidhen me furnizimin e konsumatorit në fjalë.
 8. Kur i licencuari hyn në obligime kontraktuale për blerje të energjisë elektrike për të qenë në pajtim me obligimet e këtij Neni, i Licencuari duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për t'u siguruar që blerja të jetë sa më e favorshme ekonomikisht.

Neni 15: Sigurimi i Informacioneve ndaj ZRRE-së

1. I Licencuari do t'i dorëzojë ZRRE-së informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që ZRRE-ja mund t'i konsiderojë të nevojshme.
2. I licencuari do të dorëzojë në ZRRE raporte tremujore dhe vjetore mbi veprimtarinë e furnizimit publik si dhe pajtueshmërinë me kushtet e licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga ZRRE-ja.
3. Nëse i Licencuari, në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale kërkon që ndonjë informatë të konsiderohet si konfidenciale, ai ka për obligim që të shënjojë informatën e tillë si konfidenciale dhe të arsyetoj kërkesën e tij te ZRRE-ja. ZRRE do të shqyrtojë kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. Zyra e Rregullatorit për Energji ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari do të emërojë një person përmes të cilit do të ketë lidhje komunikimi me Operatorin e Sistemit të Transmisionit dhe Operatorin e Tregut. Adresa, numri i telefonit, faksit apo adresa elektronike e personit të tillë do t'i dërgohet Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Operatorit të Tregut.
6. I Licencuari do të dërgoj ZRRE-së çdo kopje të kontratave të nënshkruara për furnizim, Marrëveshjet për Blerje të Energjisë Elektrike dhe çdo kontratë të nënshkruar në pajtim



me Marrëveshjet për Blerje të Energjisë Elektrike.

7. I licencuari do t'i dërgojë ZRRE-së detajet mbi çdo ndryshim të informatave të dërguara me aplikacionin për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacioni" - materiali në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga ZRRE-ja.

Neni 16: Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. ZRRE-ja mund të vazhdojë, modifikojë, pezullojë, dhe ndërpresë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. ZRRE-ja mund të transferojë këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga i Licencuari tjetër dhe nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të një transferimi të tillë.

Neni 17: Taksat

I Licencuari do t'i paguajë ZRRE-së çdo taksë fillestare dhe vjetore të caktuar sipas Rregullës për Taksat, të nxjerrë nga ZRRE-ja.

Neni 18: Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacioni në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga ZRRE, apo Nenet dhe kushtet e kësaj Licence, apo instruksionet e dhëna të Licencuarit nga ana e ZRRE-së, ZRRE-ja ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 52 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 19: Zgjidhja e Kontesteve



1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet sipas Rregullës për Zgjedhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga ZRRE-ja.
2. Vendimet e ZRRE-së lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës, si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve në fuqi, mund të kontestohen nga i Licencuari në Gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.